



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:079000  
Datë: 24.05.2024  
Numri i dokumentit: 05730378

C.nr.1080/23

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Mirjeta Shala, në çështjen juridike kontestimore të paditësit T.GJ., nga fshati .... dhe D.XH., , të cilët i përfaqëson Feride Xani, avokate ne Gjakovë, kundër të paditurit SH,Z., nga Gjakova, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ergjymet Barbullushi, avokat në Gjakovë, me objekt kontesti kompensimi dëmi, në seancën e datës 24.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSIDEROHET e tërhequr padia e ushtruar nga paditësit T.Gj., dhe d.GJ., e paraqitur me datën 28 gusht 2018, e ushtruar ndaj të paditurit SH,Z., , nga Gjakova, në këtë çështjen juridik.
- II. DETYROHEN paditësit T,Gj., dhe D.Gj., që në emër të shpenzimeve të procedurës që në mënyrë solidare, të paditurit të ia paguaj shumën prej 202.80 në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, nën kërcënim të përmbarrimit.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij ka ushtruar padi me datë 28.08.2018 kundër të paditurit Sh.Z. , duke kërkuar borxhin e papaguar në emër të shpenzimet të energjisë elektrike në lartësi prej 852.79 euro dhe shpenzimeve të ujit në lartësi prej 901.90 euro, ku ka bërë edhe rregullimin e padie në aspektin subjektiv duke theksuar se si paditës janë T,Gj., dhe D.N.,. Kjo për shkak se ka pretenduar se i padituri ka shfrytëzuar me qira shtëpinë që nga vit 2008 deri në viti 2017, dhe paditësit i ka shkaktuar dem në lartësi prej 1400, 91 euro. Mbi kete baze i ka kërkuar gjykatës aprovomini e padisë.

Në këtë çështje juridiko kontestimore, kjo gjykatë fillimisht ka vendosur me Aktgjykimin C.nr. të datës 0811.2019, duke e miratuar si të bazuar padinë e paditësve. Gjykata e Apelit me aktvendimin Ac.nr.152/2020 të datës 04.05.2023 e ka aprovuar ankesën e të paditurit dhe e ka kthyer çështjen në rigjykim dhe rivendosje të serishme.

Në ri procedurë, gjykata pas plotësimit të kushteve ligjore, ka caktuar seancën përgatitore me datë 24.05.2024, ku nuk ka marrë pjesë e autorizuara e paditësve e ftuar në mënyrë të rregullt (provë: flet kthesa e pranuar me datë 24.04.2024), e cili mungesën nuk e ka arsyetuar.

Në këtë seancë ka prezantuar i padituri personalisht dhe i autorizuari i tij i cili ka deklaruar se meqenëse pala paditëse është ftuar në mënyrë të rregullt dhe mungesën nuk e ka arsyetuar i propozoi gjykatës që padinë në këtë çështje kontestuese ta konsideroi të tërhequr. Kërkoj shpenzimet për përfaqësim në dy shqyrtime, dhe atë për një shqyrtim të shtyrë në shumë prej 67.60 euro dhe një seancë të mbajtur 135.20 në shumën e përgjithshme 202.80 euro.

Neni 409 par.1 i LPK-së, në mënyrë decidive parashihet se *“Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet”*, e që në rastin konkret e autorizuara e paditësve ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullt, në seancë nuk ka prezantuar siç edhe u theksua më lartë, dhe mungesën nuk e ka arsyetuar. Në anën tjetër i autorizuari i të paditurit nuk ka kërkuar që seanca të mbahet në mungesë por që e njëjta të konsiderohet e tërhequr. Andaj, gjykata erdhi në përfundim se duhet vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Vendimin lidhur me shpenzimet gjykata e morri në kuptim të nenit 450 lidhur me nenin 463 të LPK-së, duke ia njohur shpenzimet e kërkuara palës së paditur dhe atë në shumën e përgjithshme prej 202,80 €, përkatësisht 104.00 euro në emër të përpilimit të përgjigjes në padi si dhe 67.60 euro për një seancë të shtyer dhe një seancë të mbajtur 135.20 euro.

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, e konform nenit 409 paragrafi 1 në lidhje me nenin 387 par.1 pika c) të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

#### GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

-Departamenti i Përgjithshëm-  
C.nr.1080/23, datë 24.05.2024

Gjyqtarja,  
Mirjeta Shala

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktvendimi, pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.